



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 4.11.2024, ora 16:00

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE I

Drejton tryezën: Ardian Haçaj

Rendi i ditës:

Integriteti i administratës publike dhe ofrimi i shërbimeve digjitale për parandalimin e korrupsionit.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Milva Ekonomi, Eduard Shalsi, Etilda Gjonaj, Evis Kushi, Besarta Vladi dhe Esmeralda Dida.

Të ftuar:

Ardian Haçaj, Geron Kamberi, Stela Suloti, Migena Leskoviku, Adea Pirdeni, Adela Tagani, Adelina Farrici, Adena Vangjeli, Aleksander Maskvic, Afred Daci, Amanda Kote, Ansi Shundi, Anxhela Bakiasi, Ardian Hackaj, Ardita Seknaj, Artan Kotro, Avjerina Bazaj, Donjet Gjokaj, Drisid Malaj, Elona Hoxhaj, Elvin Gjevori, Emerlinda Pema, Endri Teta, Enfrid Islami, Enkela Dudushi, Enkelejd Musoslliu, Erisa Proko, Esmeralda Kazia, Geron Kamberi, Igli Tafa, Ilda Muçmataj, Iris Aliaj, Isabelle Delic, Jona Suli, Juelda Lamce, Kejsi Rizo, Klesta Hysi, Krisela Hackaj, Majlinda Thomaj, Marcela Kereku, Marina Brega, Marsel Llukmani, Michael Boll, Mirlinda Karcana, Monika Canco, Nevila Repishti, Reald Keta, Rinor Beka, Romina Kostani, Rovenja Pregja, Silvana Rusi, Sofjana Veliu, Stela Suloti, Teuta Xhindi, Valbona Kuko, Vilma Shurdha, Xhuljeta Mihoni dhe Zoran Jachev.

HAPET MBLEDHJA

Ardian Haçaj - ...të prezantimit të gjetjeve analitike nga shoqëria civile dhe komuniteti akademik shqiptar, pjesë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Kjo tryezë do të fokusohet në integritetin e administratës publike dhe në ofrimin e shërbimeve digjitale në lidhje me parandalimin e korrupsionit.

E mirëpritur në Kuvend, kjo tryezë është e para në një seri prezantimesh nga anëtarë të shoqërisë civile në Shqipëri, që janë pjesë e një grupi ekspertësh më të gjerë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar. E përsëris edhe një herë: është shoqëria civile ajo që prezanton gjetjet, nuk është komisioni.

Synimi i komisionit është thellimi i reformave, me objektiv anëtarësimin e vendit në vitin 2030. Puna e komisionit, sipas dokumentit normativ themelues fokusohet në tri shtylla: mirëqeverisjen, antikorrupsionin, sundimin e ligjit.

Si i tillë, ky komision sapo është përmendur edhe në raportprogresin, që nënvizon rëndësinë e kësaj iniciative, por puna e këtij komisioni përfshin dhe shkon përtej detyrimeve që ka vendi përkundrejt BE-së. Në qëllimin e komisionit, në aktin e themelimit, është mbi të gjitha interesi i qytetarëve dhe e ardhmja e vendit.

Çdo shtyllë: mirëqeverisja, antikorrupsioni dhe sundimi i ligjit kanë disa kapituj. Sot do të prezantojmë tre kapituj. Do të prezantojmë integritetin dhe etikën në administratën publike për parandalimin e korrupsionit. Do të prezantojmë ofrimin e shërbimeve digjitale. Duke marrë parasysh edhe mënyrën se si i relatojnë njëri-tjetrit, do të bashkohen dy kapituj nga shtylla e mirëqeverisjes, dhe pastaj do të diskutojmë për një kapitull tjetër në shtyllën e antikorrupsionit.

Analiza që do të prezantohet, çdo kapitull i prezantuar nga një pjesëtar i shoqërisë civile dhe i komunitetit akademik, do të fokusohet te gjetjet, te prioritetet dhe rekomandimet për debat. Dokumentet, qasjet analitike janë përgatitur në uebsajtin përkatës, me përmbledhje lehtësisht të konsultueshme. Prezantuesit, për lehtësi dhe për një debat të strukturuar kanë përgatitur disa vizatime në *PowerPoint*, që do t'i ndajnë me ne. Çdo prezantim zgjat rreth dhjetë minuta. Dy prezantimet e para do t'i kemi në shtyllën e mirëqeverisjes. Do të kemi një debat, ku anëtarët prezentë në këtë sallë do të sjellin komentet, vërejtjet, kritikën, sugjerimet e propozimet e tyre. Do t'ju lutesha shumë që çdo kontribut të mos jetë më i gjatë se pesë minuta.

Seanca është e hapur për mediat. Nuk e di nëse ka media apo jo. Pas prezantimit dhe debatit të dytë, zonja Ikonimi do të marrë fjalën për të nënvizuar disa pika kryesore që kanë

dalë nga ky debat dhe për të shpjeguar hapat vijues sa i përket procesit të konsultimit dhe modaliteteve të mbledhjes së opinioneve nga të gjithë anëtarët e interesuar.

Pa u vonuar më tepër, po ia lë fjalën zotit Geron Kamberi, nga Qendra për Studimin e Demokracisë e të Qeverisjes.

Geron Kamberi – Faleminderit, Ardian!

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

Ashtu siç u përmend edhe nga Ardiani, unë jam këtu në cilësinë e përfaqësuesit të një grupi ekspertësh, që kemi punuar për këtë kapitull të shtyllës që lidhet me mirëqeverisjen, e që ka të bëjë me disa gjetje dhe rekomandime që na kanë dalë nga një analizë analitike që ne kemi bërë pikërisht për këtë shtyllë të mirëqeverisjes. Në mënyrë të përmblodhur unë do të paraqes para jush disa prej gjetjeve e rekomandimeve mbi këtë shtyllë të mirëqeverisjes, siç është etika dhe integriteti. Kolegia ime që kam në krah, zonja Iris Aliaj, do të ndalet te disa elemente të tjera të shtyllës së mirëqeverisjes.

Ne gjykojmë se analiza e situatës së etikës dhe integritetit të administratës publike në Shqipëri merr një vlerë të veçantë, duke pasur parasysh situatën ku ndodhet vendi, gjë që u përmend këtu edhe pak më parë, që prej 15 tetorit Shqipëria ka nisur një rrugëtim tjetër, ka hyrë në një fazë tjetër të procesit të integritetit europian. Elementi që lidhet me mirëfunksionimin e administratës publike, dhe kur them mirëfunksionim kam parasysh që nga etika, integriteti, parandalimi i korrupsionit dhe të gjitha elementet e tjera, që bëjnë të mundur që një administratë të mirëfunksionojë përballë qytetarëve me shërbimet që ofron. Në këtë mënyrë analiza jonë, bashkë me ne, grupin e ekspertëve të përfshirë në këtë shtyllë të mirëqeverisjes, ka synuar pikërisht këtë fakt: të bëjë një vlerësim të gjithçkaje të arritur deri tani, sepse nuk punojmë në një terren të zbrazur. Prej më shumë se 32 vjetësh, deri në momentin kur mbërriti në hapjen zyrtare të negociatave me Bashkimin Europian, Shqipëria ka kaluar nëpër shumë faza reformash, dhe administrata publike ka qenë një nga institucionet apo një nga sektorët që ka përjetuar reforma në mënyrë të vazhdueshme, dhe do të vazhdojë të jetë edhe më tej subjekt i reformave.

Për sa i përket progresit dhe arritjeve, ajo që kemi arritur të analizojmë gjatë pjesës së vlerësimit të këtij dokumenti analitik në lidhje me etikën në administratën publike, një nga elementet kryesore ka qenë kuadri ligjor e institucional. Nga pikëpamja e kuadrit ligjor, që prej vitit 2003 Shqipëria ka një ligj “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i hartuar sipas modelit të Këshillit të Europës, i cili deri tani ka rregulluar normat e etikës brenda nëpunësve të administratës publike, ashtu siç ka edhe vendime e akte nënligjore, që e kanë pasuar. Ajo që ka rëndësi veçanërisht është një vendim i vitit 2021 për miratimin e rregullave për zbatimin e

etikës dhe klasifikimin e aktiviteteve të jashtme që cenojnë ose jo parimet e etikës së nëpunësit të administratës publike.

Dokumenti më i rëndësishëm nga pikëpamja ligjore e strategjike, që ka aktualisht qeveria shqiptare, që është miratuar vitin e kaluar, është Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, i cili do të jetë dokumenti që do ta udhëheqë qeverinë shqiptare në procesin negociator për të gjithë ato elemente që do të përcaktohen në lidhje me reformën në administratën publike.

Natyrisht, nga ky moment që po flasim, si një nga arritjet që ne kemi vlerësuar ka qenë manuali i rregullave etike, që është hartuar për nëpunësit e administratës publike, udhëzuesit mbi elementet procedurale e materiale për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore dhe metodologjia për monitorimin e zbatimit të rregullave të administratës publike.

Brenda këtij kuadri strategjik qeveria shqiptare synon që në institucionin e administratës publike të ketë edhe një pozicion të këshilltarit për integritet dhe etikë publike, i cili gjykojmë dhe besojmë se do ta ngrejë në nivel tjetër zbatimin e parimeve të etikës dhe integritetit brenda administratës publike.

Në mënyrë të përmbledhur, arrita të paraqes një kuadër të përgjithshëm të atyre që janë progresi dhe arritjet në fushën e administratës publike. Natyrisht, në një prezantim dhjetëminutësh nuk mund të arrish të përmbledhësh ecurinë që ka pasur administrata publike në kaq vite, në këtë moment që po flasim, por natyrisht, studimi i plotë dhe përmbledhja, të cilën ju mund ta aksesoni në faqen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, mund t'ju ofrojë një këndvështrim më të plotë, ashtu si dhe studimi i plotë që do të jetë në një fazë të mëvonshme.

Çfarë kemi vlerësuar ne si gjetje apo problematika nga vlerësimi analitik, ka qenë mungesa e një zinxhiri të qartë hapash, procedurash dhe afatesh ligjore në rastet kur ka shkelje të Kodit të Etikës e të integritetit nga ana e zyrtarëve dhe nëpunësve publikë, apo kur ata denoncohen në forma të ndryshme, veçanërisht nga qytetarë, media apo grupe interesi.

Natyrisht, një element tjetër që kemi evidentuar është mungesa e udhëzimeve të detajuara për garantimin e paanshmërisë së komisioneve të etikës, në rastet kur ata shqyrtojnë shkelje të këtij Kodi nga zyrtarë të lartë të qeverisë, jo thjesht nga nëpunës të administratës publike.

Një element tjetër që e kemi evidentuar si problematik ka qenë mungesa e besimit të mekanizmi i sinjalizuesve, i cili është një risi për administratën shqiptare, që prej miratimit të ligjit në vitin 2016, duke marrë një nga modelet më të avancuara për krijimin e rrjetit të sinjalizuesve brenda administratës publike, por nga vlerësimi që kemi bërë ai nuk ka arritur të

prodhojë rezultate të prekshme për shumë arsye, të cilat i kemi përmendur edhe në studim, që është më i gjerë e më i plotë.

Nga ana tjetër ligji “Për rregullat e etikës së administratës publike”, i miratuar në vitin 2003, në momente të caktuara ka një mbivendosje ndërmjet përmbajtjes dhe dispozitave të ligjit të vitit 2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit”. Në këtë kuadër sugjerohet që të ketë një ligj unik, i cili mund t’i shkrijë këto të dyja, sa i përket Kodit të Etikës dhe integritetit në administratën publike.

Nga ana tjetër, një gjetje dhe problematikë që kemi evidentuar nga ligji “Për rregullat e etikës së administratës publike”, i cili është ligji bazë që rregullon këtë pjesë, ka qenë fakti i mospërcaktimit në mënyrë të qartë se çfarë ndodh me nëpunësit e administratës publike, por edhe me zyrtarët politikë, pasi ato lënë funksionet e tyre, qoftë në administratë e qoftë rikthimin e tyre në sektorin privat apo në sektorë të tjerë. Ky debat është jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shumë vende të tjera, se çfarë parimesh etike duhet të zbatojë një zyrtar, që të shmangë konfliktin e interesit, kur lë punën dhe rikthehet në institucionet me të cilat mund ta ketë lidhur puna gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik.

Te rekomandimet, nga të cilat po përmbledh disa, ka qenë edhe rishikimi i ligjit “Për rregullat e etikës së administratës publike”, në mënyrë që të jetë pjesë integrale e gjithë sistemit të menaxhimit të parimeve të etikës në administratë. Siç e kemi përmendur edhe në vlerësimin tonë analitik, ai ka rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh se në udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës është parashikuar edhe një rishikim i ligjit për konfliktin e interesit. Ndoshta do të ishte mirë që të dyja këto ligje të shikohen e të kenë një lloj harmonie mes tyre.

Një tjetër element me rëndësi ka qenë rishikimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e sistemit të sinjalizuesve dhe rritjen e efikasitetit të zbatimit të tyre qoftë në nivel qendror, qoftë në nivel lokal, në mënyrë që ai të garantojë edhe përmbushjen e funksionit të tij, si një strukturë që u pa si risi në vitin 2016, kur u miratua nga Parlamenti shqiptar, por që duhet të arrijë një shkallë të lartë efikasiteti, në përmbushje të detyrimeve që përcakton ligji për sinjalizuesin. Brenda kësaj, një nga sugjerimet e rekomandimet që i bëjmë Komisionit të Posaçëm është krijimi i një rrjeti për mbrojtjen e sinjalizuesve në administratën publike, pasi shpesh pika më e dobët e rrjetit të sinjalizuesve ka të bëjë me zyrtarë publikë, të cilët marrin guximin të denoncojnë shkelje që ndodhin brenda institucioneve të administratës publike. Pra, kërkohet të krijohet një kulturë tjetër për të inkurajuar veprimtarinë e tyre si strukturë brenda administratës.

Në mënyrë të përmbledhur, këto ishin disa nga gjetjet, rekomandimet e problematikat që ne kemi parë në lidhje me këtë pjesë, pasi kolegja ime do të flasë në mënyrë më të shtjelluar për disa elemente të tjera që lidhen me shtyllën e etikës e të integritetit të administratës publike.

Disa nga pyetjet që ne kemi ngritur e që mendojmë se mund të jenë edhe shkas për diskutim, është: sa e përmirësojnë mekanizmat që aktualisht janë në fuqi nxitjen e etikës e të integritetit në administratën publike, veçanërisht krijimin e besimit te qytetarët, që janë konsumatorët e drejtpërdrejtë të shërbimeve publike e të marrëdhënieve të drejtpërdrejta që krijojnë me administratën publike.

Një tjetër element, ose një tjetër pyetje, që ne mendojmë se ka vlerë për publikun e për misionin e komisionit të krijuar, është: sa të mbrojtur janë zyrtarët brenda administratës publike, të cilët denoncojnë rastet korruptive brenda institucioneve të tyre, përfshi këtu shkeljen e procedurave apo elemente të tjera, që janë të pranishëm në praktikën administrative.

Një element tjetër që ne kemi parë dhe mendojmë se ka vlerë për t'u diskutuar, është fakti se çfarë mekanizmash mund të ndërtohen në Shqipëri, duke pasur parasysh kontekstin e një vendi të vogël, ku të gjithë i njohin të gjithë, në mënyrë që ligji për parandalimin e konfliktit të interesit të gjejë zbatim e të jetë funksional.

Faleminderit për vëmendjen!

Në mënyrë të përmbledhur këto ishin disa nga elementet e dokumentit analitik. Ndërkohë, kolegja Iris Aliaj do të vazhdojë me disa elemente të tjera, që janë pjesë e shtyllës së etikës dhe integritetit në administratën publike.

Ardian Haçaj – Shumë faleminderit, Geron!

Siç e vutë re, koha ishte dhjetë minuta, që i bie fiks 600 sekonda, për prezantimin e parë. Do të mundohemi ta mbajmë këtë ritëm deri në fund të seancës. Thjesht desha të nënvizoja dy pika, që mund të jenë interesante për të strukturuar debatin. Kryesisht, arritjet janë në aksin normativ institucional, Geron, mund të më korrigjosh nëse jam gabim, ndërsa rekomandimet janë kryesisht në harmonizimin e ligjeve ekzistuese, në përmbushjen e këtyre ligjeve me nënligjet, me standardet e me normat.

Fjala për ju!

Iris Aliaj – Faleminderit, zoti Haçaj!

Përsëndetje të gjithëve!

Në fakt, për mua është kënaqësi të prezantoj sot gjetjet e grupit të punës së ekspertëve, të cilët janë angazhuar pranë shtyllës së dytë të antikorrupsionit.

Do të doja të sillja në vëmendjen tuaj faktin që kjo është një analizë shumë e gjerë, e zgjeruar, e thelluar, e cila është realizuar nga një sërë ekspertësh, por që sot unë kam kënaqësinë ta prezantoj. E përmendi pak edhe zoti Kamberi, që disa çështje mund t'ju duken pak edhe si mbivendosje, por unë do t'i paraqes të gjitha gjetjet, duke i parë nga këndvështrimi i antikorrupsionit. Nga ana tjetër shtyllat, të tria shtyllat e këtij komisioni të posaçëm, që janë

krijuar në Kuvend, janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Kjo për vetë faktin se ne sot po flasim e po diskutojmë për çështje që lidhen me antikorrupsionin, çështje të cilat kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse, e pa diskutim që mirëqeverisja dhe antikorrupsioni janë pjesë përbërëse dhe plotësojnë njëra-tjetrën

Sa u takon gjetjeve që janë evidentuar në këtë analizë aktuale, ato lidhen me çështjen e korrupsionit në Shqipëri, për të cilën pa diskutim që kemi mbajtur në konsideratë edhe raporte të ndryshme ndërkombëtare, por nga ana tjetër edhe të organizatave vendëse. Nga të dyja këto raporte ka rezultuar që korrupsioni ka qenë e vijon të mbetet një sfidë, duke u manifestuar në nivelet e qeverisjes vendore, në nivelet vendore, ashtu edhe në atë privat.

Raporte të ndryshme, si progresraportet, raporti *screening* për grupin e parë “Themelorët”, si dhe raporti i Komisionit European i shtetit të së drejtës, i vitit 2024, kanë vlerësuar të gjitha masat që shteti shqiptar ka ndërmarrë për sa i përket kuadrit institucional, ligjor, politik, luftën për parandalimin e korrupsionit. Në fakt është evidentuar një farë progresi në këtë kuadër. Megjithatë, pavarësisht kësaj, është evidentuar se korrupsioni është i përhapur në shumë sektorë të jetës publike e të biznesit. Masat parandaluese që janë ndërmarrë deri tani kanë pasur një ndikim të kufizuar, veçanërisht në sektorë që konsiderohen me risk të lartë. Për këtë kërkohen qasje e mekanizma që janë më të përshtatshme për të siguruar transparencën, por nga ana tjetër edhe integritetin e institucioneve e të tregut.

Unë nuk u ndala te reformat e ndërmarra, por pa diskutim që ato kanë qenë pjesë e analizës sonë. I gjithë legjislacioni dhe gjithë ndryshimet ligjore kanë përmirësim, gjë që është evidentuar edhe nga raportet ndërkombëtare e vendase në luftën kundër korrupsionit edhe për çështje që lidhen me parandalimin. Megjithatë, është evidentuar se kjo është një qasje e shtrirë më shumë në pushtetin qendror sesa në atë vendor.

Gjithashtu, për çështje që lidhen me parandalimin e korrupsionit, me integritetin e zyrtarëve publikë dhe nëpunësve civilë, Komisioni European ka konstatuar se kuadri rregullator është gjithëpërfshirës nga njëra anë, por nga ana tjetër është i fragmentuar, pra jo i mjaftueshëm për të luftuar korrupsionin.

Pa diskutim që të gjithë biem dakord se reforma në drejtësi dhe i gjithë legjislacioni që u ndryshua në këtë kuadër, por edhe institucionet e reja që u krijuan, si SPAK-u dhe BKH-ja, kanë mundësuar hedhjen e hapave të rëndësishëm dhe ndryshime sa i përket goditjes së korrupsionit në nivele të larta, por nga ana tjetër edhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj kësaj çështjeje.

Nëse i referohemi raportit të shqyrtimit analitik të grup-kapitujve të parë “Themelorët”, është evidentuar se Shqipëria ka zbatuar legjislacionin që lidhet me promovimin e integritetit,

përfshirë ligjet që lidhen me vlerësimin e zyrtarëve publikë dhe kandidatëve politikë, por sfidat ngelen në atë që ne diskutojmë shpeshherë edhe në tryeza, në lidhje me zbatimin e legjislacionit, por nga ana tjetër edhe përafrimin e legjislacionit me standardet e Bashkimit European dhe me *acquis* të BE-së.

Progresraporti i fundit për Shqipërinë, i vitit 2024, në drejtim të integritetit të zyrtarëve publikë, në tërësi ka konstatuar se ndërgjegjësimi i zyrtarëve publikë për standardet etike e për mënyrën se si ato duhet të zbatohen, është shprehur se duhet të përmirësohet. Sa i përket figurës, integritetit dhe dekriminalizimit, mekanizmat kontrollues për drejtuesit e lartë në administratën publike, në nivelin qendror dhe vendor, sa u përket edhe nëpunësve të shërbimit civil, që zbatohet nga DAP-i, janë gjetur disa arritje, të cilat janë masa edhe efektive, edhe të zbatuara mirë. Kjo është në bazë të raportit të fundit që ka përgatitur Departamenti Amerikan i Shtetit për vitin 2023.

Gjithashtu, edhe për sa i përket nivelit qendror e vendor, është vënë re se planet e integritetit dhe përpjekja për sigurimin e transparencës janë vlerësuar si arritje sa i përket forcimit në tërësi të integritetit në institucione. Nga ana tjetër, është evidentuar se të gjitha nivelet e qeverisjes vijojnë të përballen me sfida në zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të planeve të integritetit, që pengohet nga mungesa e një metodologjie, e cila është e unifikuar, por edhe nga fakti se pjesa buxhetore nuk është e mjaftueshme. Kryesisht, kjo është parë edhe në kuadër të pushtetit vendor.

Nëse i referohemi raportit të GRECO-s, të vitit 2022, është konstatuar se planet e integritetit kërkojnë marrjen e masave të mëtijshme për të siguruar monitorimin dhe pajtueshmërinë me planet në të gjitha ministrinë. Në këtë linjë vjen edhe konstatimi i Komisionit European, në progresraportin e fundit, atë të vitit 2024, ku është vënë në dukje fakti se cilësia e zbatimit të planeve të integritetit, të krijuara në nivel qendror e vendor mbetet e dobët.

Sa i përket konfliktit të interesit për drejtuesit e nivelit të lartë dhe administratën publike, ka një sërë parashikimesh ligjore, pavarësisht faktit se sipas raportit të shqyrtimit analitik të grup-kapitujve të parë “Themelorët”, theksohet se kuadri ligjor në fuqi për konfliktin e interesit nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare, arsye për të cilën është e nevojshme të përafrohet me to. Edhe GRECO në raundin e pestë të vlerësimit të tij ka rekomanduar se *e-Platforma* duhet të vihet në punë për publikimin dhe paraqitjen e deklaratave të pasurisë e interesit. Ka qenë edhe një nismë e ndërmarrë më parë nga ILDKPI-ja, në lidhje me përgatitjen e një draftligji për konfliktin e interesit, por nuk i është nënshtruar konsultimit

publik. Një ndër masat kryesore që parashikohen edhe në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës, është miratimi i ligjit për konfliktin e interesit.

Sa u përket kufizimeve për pjesën e punësimit, shumë shkurtimisht mund të them që, siç është nënvizuar nga raportet, edhe OECD-ja, rregullat që lidhen me kufizimet pas punës në administratë vijojnë të jenë të pakta. Kësisoj, edhe kjo ka nevojë për një vëmendje të shtuar.

Pa diskutim që reforma digjitale është vlerësuar. 95 % e shërbimeve janë digjitale, gjë që nga njëra ka kufizuar korrupsionin e vogël, atë që konsiderohet korrupsioni i sporteleve, por duhen parë edhe nivelet më makro, të cilat lidhen me proceset administrative. Edhe pjesa e rekrutimit është vlerësuar sa u përket masave të ndërmarra, të cilat janë parashikuar edhe në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike. Janë evidentuar disa problematika, sidomos në lidhje me punësimin e punonjësve në nivel TND-je apo në lidhje me aplikimet që bëjnë punonjës të ndryshëm, pasi në këtë kuadër nuk është zbatuar legjislacioni. Ne grupi i ekspertëve mezi presim të diskutojmë e të marrim mendime nga ana juaj, për të ndarë edhe eksperiencat në këtë kuadër, por edhe kritikën, me qëllim përmirësimin e analizës që jemi duke realizuar.

Kësisoj, në kuadër të propozimeve, duke qenë se rekomandimet dhe gjetjet e mësipërme ndalen pikërisht sa i përket legjislacionit, si një komponent i rëndësishëm, ne mendojmë të propozojmë harmonizimin dhe njësimin e legjislacionit për parandalimin e korrupsionit dhe integritetin e zyrtarëve publikë përmes njëtrajtësisë së procedurave dhe autoriteteve zbatuese. Madje, sugjerojmë të ketë edhe një kod të integritetit publik.

Nga ana tjetër, plotësimi dhe rishikimi i kuadrit rregullator të veprimtarisë së administratës qendrore e vendore për konfliktin e interesit është e rëndësishme të jetë në përputhje me standardet e me *acquis* të Bashkimit Europian. Gjithashtu, sugjerojmë të krijohet një *track record* ose një listë në lidhje me zyrtarët që kanë kryer dhe kryejnë shkelje të konfliktit të interesave; përcaktimin dhe parashikimet ligjore lidhur me kohëzgjatjen dhe kufizimet e ndalimit në pozicione për përcaktimin e konfliktit të interesit në punësimet në sektorin privat dhe funksionin publik. Po ashtu, jemi ndalur edhe në çështje që lidhen me rëndësinë dhe rolin që kanë organizatat e shoqërisë civile në lidhje me monitorimin dhe përparimin e niveleve të qeverisjes si në nivel qendror ashtu edhe vendor.

Kemi ngritur disa teza për diskutim publik, që lidhen me çështjen se si mund të promovohet një kulturë integriteti në administratën publike, ose çfarë masash sugjerohen nga ana juaj, duke qenë se, ashtu siç biem të gjithë dakord, korrupsioni nuk është çështje e lehtë, por goxha e vështirë, komplekse dhe kërkon një angazhim me të gjitha institucionet përgjegjëse. Në këtë kuadër, pa diskutim që edhe qytetarët, edhe shoqëria civile e kanë një rol.

Ju falënderoj!

Ardian Haçaj – Faleminderit!

Thjesht desha të nënvizoja disa pika që më kanë tërhequr vëmendjen gjatë konsultimit të dokumenteve, të cilat i rekomandoj shumë fort, sepse janë dokumente analitike, thelbësore e gjithëpërfshirëse: diskutimi me ekspertët, por edhe prezantimi këtu.

Së pari, është nënvizimi mbi qasjen gjithëpërfshirëse.

Së dyti, është një qasje e diferencuar sipas specifikës së sektorëve.

Së treti, është një diferencë, që ne e vëmë re jo vetëm në këtë rast, por edhe në sektorë të tjerë, një vëmendje të përqendruar në pushtetin qendror, e jo edhe aq sa duhet në pushtetin vendor, kuadri ligjor i fragmentuar, sfida që ngelet, që është zbatimi. Besoj se ky ka për të qenë një nga lajtmotivet e këtij komisioni, mënjanimi i përjashtimeve.

E theksoj edhe një herë risinë që sjell ky debat mbi nevojën për harmonizim, pas ndërtimit të një arkitekture në bazë të reformave të ndryshme, me sa duket ka ardhur koha për të harmonizuar ligjet dhe bashkëpunimin ndërinstytucional, por sidomos për ta bërë më fluid, më efikas, më eficient funksionimin e brendshëm të vetë këtyre institucioneve të reja.

Po përmend disa pyetje, disa pika, që ngriti zoti Kamberi, për të hapur debatin deri në orën 17. Geron, më korrigjo nëse anashkaloj ndonjë gjë.

Së pari, ishte impakti në terren.

Së dyti ishte mbrojtja e zyrtarëve. Gjithashtu, një pikë interesante ishte përshtatja me kontekstin vendor të gjithë këtyre reformave e të kësaj faze që ka të bëjë me funksionimin, për të siguruar reziliencën dhe efikasitetin e të gjitha përpjekjeve që po bëjnë aktorët në vend përkundrejt, e përsëris edhe një herë, targetit të 2030-ës.

Salla është e hapur për pyetje e përgjigje.

Do t'ju lutesha që kur ta merrni fjalën, të prezantoheshit me emrin tuaj dhe institucionin. Secili do të ketë pesë minuta kohë. Unë do të mbledh tri-katër pyetjet e para, për një përgjigje të harmonizuar nga të dy parafolësit. Pastaj do të vazhdojmë me radhë.

Kemi një pyetje nga zonja Kuko.

Ka ndokush ndonjë pyetje tjetër, koment, kritikë, sugjerim?

Valbona Kuko – Faleminderit!

Unë jam Valbona Kuko, drejtore e Fondacionit...

(Incizim i dobët)

Drejtore e *Westminster Foundation for Democracy*, Tiranë.

(Ndërprerje incizimi)

Ardian Haçaj – Sugjeroj të vazhdojmë pa mikrofon. Do të mundohemi që kolegëve të cilët nuk e flasin gjuhën, t'u bëjmë një përmbledhje pak më vonë, por gjithsesi në rastin më të mirë e më të shpejtë.

(Ndërprerje incizimi)

Ah, më falni!

Zonjë, a ka mundësi një mikrofon të lëvizshëm, për t'u dëgjuar ne më mirë?

(Ndërprerje incizimi)

Valbona Kuko – ...temën e çështjeve për diskutim, duke parashtruar edhe dy çështje të tjera, të cilat për hir të së vërtetës kanë qenë sfiduese edhe për vetë grupin tonë, në kohën kur kemi diskutuar përgatitjen e dokumentit.

Pikësëpari, cili mund të jetë një mekanizëm efikas shtrëngues, për t'i bërë të zbatueshme rregullat e paspunësimit, sepse ka çaluar për shkak se nuk parashikon mekanizëm shtrëngues? Cili mund të jetë mekanizmi që do ta bëjë efektiv mekanizmin e ri të prezantuar, që parashikon kufizimet e paspunësimit?

Duke qenë se ne folëm gjatë, sepse ka qenë edhe kërkesë e vijueshme e raporteve, me qëllim që të përcaktohen rregulla që kufizojmë punësimin pas përfundimit të funksionit publik, çështja që ka qenë sfiduese për ne lidhet me faktin nëse është nevoja apo momenti që të përcaktohen edhe kufizime para punësimit. Kjo nëse dikush nga sektori privat merr një funksion publik, për të avancuar interesat e sektorit përkatës privat. A është momenti që ne të vijojmë apo të përcaktojmë rregulla, sigurisht për pozicione të caktuara, edhe përpara punësimit? Natyrisht, disa modele i kemi, por janë shumë të kufizuara.

Ju faleminderit!

Ardian Haçaj – Faleminderit!

Edhe një pyetje tjetër?

Në rregull, vazhdojmë me përgjigjet nga paneli. Thjesht për kolegët, për përkthimin në anglisht.

Zonja Kuko foli në lidhje me metodologjinë e përdorur për zbatimin në praktikë, se ku çalon? Gjithnjë nëse ka informacione se ku çalon metodologjia e zbatimit. Zonja Kuko ngriti gjithashtu edhe çështjen që ka të bëjë me rëndësinë e parandalimit, si dhe nevojën për një analizë postlegjislative, që të kemi mundësi për të pasur një pamje shteruese, një analizë shteruese në lidhje me hapat që vijnë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Mirdita të gjithëve!

Mirëmbërëma të gjithëve, që jeni mbledhur sot në këtë tryezë. Të më falni shumë, që e mora fjalën para folësve!

Para se t'ia japim edhe një herë fjalën dy përfaqësuesve të grupit të ekspertëve të lartë, unë do të kisha nevojë të bëja një përmbledhje të vogël për të sqaruar diçka, meqenëse më nxiti fjala e zonjës Kuko.

Së pari, do të doja të falënderoja grupin e ekspertëve të lartë, por edhe të ekspertëve të mesëm, që janë treguar heroikë, që kanë punuar me orar e pa orar, me pushime e pa pushime, në të shtuna e në të diela. Duke thënë këtë, dua të tregoj se si funksionoi ky komision, që në fakt, kur zoti Xhafaj e krijoi, mbase ka pasur edhe nga ata që janë treguar skeptikë, çka se unë për veten time nuk kam qenë skeptike. Çfarë besoja unë? Unë besoja se, nëse ne kemi procesin e *screening* dhe procesin e diskutimeve me BE-në, për t'u bërë pjesë e gjithë ndryshimeve që do të vijnë në shtetbërjen shqiptare, që do të nisej nga parimet e Bashkimit European, jo vetëm që do të uleshim në tryezë me ta, dhe ata do të na thoshin disa detyra që duhej të arrinim t'i bënim, unë besoja fort se për ne do të ishte e rëndësishme që ta thërrisnim BE-në këtu, sepse kështu ne mund të bëjmë gjërat që na thotë BE-ja, por a e dimë ne se sa probleme tjera të vogla kemi brenda gjërave tona, që duhen ndryshuar? E nuk kishte ku të gjendej një vend më i mirë se sa Parlamenti i Shqipërisë, që të ndodhte kjo. Pse? Sepse Parlamenti i Shqipërisë është ajo godina e madhe, e cila mbledh ata që janë përfaqësues të popullit. Unë besoj se të gjithë ju, që punuat në verë, menduat me veten tuaj se kjo është një detyrë për Shqipërinë, kjo është një detyrë për ne, nuk është një detyrë për ekspertin Jonidë, nuk është një detyrë për ekspertin Migenë, por një detyrë pak më e madhe. E kjo detyrë më e madhe realizohet duke punuar të gjithë bashkë.

Në fakt, gjatë verës, në grupet e punës ne kemi pasur shumë problematikë diskutuese, por jo problematikë, që ishte mënyra se si do të punonim. Unë shikoj Vilmën që po më ndjek me vëmendje tani, sepse mbajmë mend diskutimet që kemi bërë në lidhje me mënyrën se si duhej të punonim, çfarë do të sillnim ne këtu për gjetje. Unë them “ne”, sepse jam parlamentare. Mënyra si do të vinim këtu me gjetjet do të përfshinte leximet e gjithë raporteve që ishin bërë për Shqipërinë nga Bashkimi European, nga Këshilli i Europës, nga Departamenti Amerikan i Shtetit, nga UNDP-ja e nga plot organizma ndërkombëtarë, së pari.

Së dyti, nga të gjitha OJQ-të shqiptare që punojnë për të reflektuar se si ta bëjnë më mirë.

Së treti, për të kuptuar se ka nevojë për disa ndryshime të thella në shtetbërje, e këto ndryshime të thella duhet t'i bëjmë të gjithë së bashku. Në qoftë se administrata publike u përgjigj për klasterin e parë, “Themelorët”, në shtetin shqiptar marrin pjesë edhe *stakeholder*

të tjerë, siç është shoqëria civile, siç është bota akademike, siç janë shoqatat e biznesit, siç janë organizatat e pavarura, agjencitë e pavarura. Kësisoj, të gjithë kanë nevojë të japin vëmendjen e tyre në lidhje me ata që mendojnë se duhet bërë me mirë. Prandaj, kur u bë metodologjia, u punua me këto grupe. Vërtet e drejtuam procesin në këtu, në Parlament, por asnjëri nga ne deputetët nuk qe i përfshirë, përveç se ishte një detyrë që iu la të tretëve për ta bërë. Si të thuash, ne ishim koordinatorë. Nuk vepruam, nuk vendosëm *hands on job*. *Hands on job* janë vetëm nga ky grup i ekspertëve që është ulur këtu. Në qoftë se sot janë këto shënime, janë pikërisht për faktin se grupi i ekspertëve, që ka qëmtuar me shumë kujdes të gjitha dokumentet, thotë: ne kemi një kuadër ligjor të bërë mirë, por ne nuk i kemi ca mekanizma për ta plotësuar këtë kuadër ligjor. Na mungojnë. Ne kemi ca gropa. Vërtet BE-ja na e ka thënë këtë gjë në *screening*, por ama kemi edhe disa gropa të tjera. Prandaj, kjo është një detyrë e më shumë se disa deputetëve, është një detyrë e gjithë shoqërisë, me qëllim që të shkojmë përpara. Është shumë e rëndësishme ta sqarojmë këtë gjë sa i takon metodologjisë.

Në momentin kur po binim dakord, sepse duhej ta kishim pak të unifikuar edhe procesin e punës, ka qenë një diskutim shumë i madh midis ekspertëve. Po marrim si shembull Irisin dhe Klestën, që të dyja me formim juridik, njëra që është te mirëqeverisja, tjetra është tek antikorrupsioni. Sa çështje kanë mirëqeverisja dhe antikorrupsioni, që *overlap*-in? Ka plot çështje që *overlap*-in. Atëherë si duhet të jetë drita, për të parë diçka? A do të jemi të aftë ta shikojmë dritën në mënyrë të përbashkët? A do të na duhet ta ndajmë mënyrën se si do t'i bëjmë punët? Do të na duhet ta shikojmë të gjithë bashkë këtë gjë, dhe të biem dakord se si do të jetë rrugëtimi ynë pas tryezave? Çfarë do të bëjmë ne pas këtyre tryezave? Cili do të jetë produkti i gjithë kësaj pune të madhe që ka bërë grupi i ekspertëve të lartë? Çfarë do të realizojmë në fund?

Ne e kemi një vizion tonin. Ne e dimë se për ne viti 2030 është ajo që duhet bërë, por ne duam të bëjmë një shtet të formuar edhe më mirë, duam të punojmë pak më fort.

Ky është mesazhi që më takonte t'i thosha zonjës Kuko, që në fillim të herës. Nuk e di se sa ndihmova, por gjithsesi unë do të vazhdoj ta falënderoj gjithmonë grupin e ekspertëve.

Ardian Haçaj – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Në vlerësimin tim si moderator është shumë e rëndësishme të ritheksojmë profilin e këtij komisioni të posaçëm, që shkon përtej plotësimit apo përtej raportimit të kriterëve të domosdoshme të 2030-ës, e për t'ju cituar juve, duke shkuar edhe pak më tutje, që t'i bëjmë pak më mirë, t'i përshtatim pak më shumë me kushtet në të cilat ndodhet vendi e me situatën e përgjithshme. Kjo në mënyrë që të bëhen të qëndrueshme të gjitha arritjet dhe të mos kthehemi prapa.

Kemi 12 minuta kohë për përgjigjet. E theksoi edhe një herë, zonja Kuko, se ku çalon metodologjia e përdorur për zbatimin në praktikë: komponenti i parandalimit dhe analiza postlegjislative.

Gjithashtu, janë shumë interesante edhe pyetjet e zonjës Rystemaj, mekanizmat efikasë shtrëngues për postpunësim dhe për prepunësim.

Geron Kamberi – Faleminderit!

Duke u ndalur tek ajo që përmendi Valbona pak më parë, te planet e integritetit, në fakt planet e integritetit janë një risi për administratën publike, është një metodologji e cila është hartuar dhe po zbatohet jo më shumë se dy-tri vitet e fundit. Kësisoj, në përgjithësi, si çdo metodologji e re dhe risi për administratën publike, natyrisht që pjesa e zbatimit haset gjithmonë me problematika.

Problematika kryesore që kemi ndeshur, kjo dhe sipas analizës që kemi bërë, lidhet me strukturat brenda institucioneve të administratës publike, që janë përgjegjëse për zbatimin e planit të integritetit. Ne kemi parasysh se planet e integritetit janë për çdo institucion, sepse për çdo institucion ka individë që kryejnë funksione të ndryshme gjatë punës së tyre të përditshme, se kush bën një raport në fund të vitit apo në fund të muajit, se si ka lëvizur, si ka ecur e si është zbatuar plani i integritetit për atë institucion.

Sipas gjykimit tim, por edhe të ekspertëve të tjerë, integriteti përmbledh disa elemente. Pra, një nëpunës i administratës publike, ose një institucion i administratës publike që ka integritet nënkupton një tërësi elementesh, ku përfshihet edhe etika. Pavarësisht se bëra një ndarje midis etikës, etika është paradhoma për të qenë një administratë me integritet. Etika është një nga elementet e integritetit. Një administrator publik, qoftë ky zyrtar publik, pra zyrtar i emëruar, që vjen nga niveli politik, qoftë nëpunës civil, që të quhet me integritet duhet të ketë etikë në gjithë çfarë përmban Kodi i Etikës apo ligji “Për etikën në administratën publike”, të ketë performancë, gjë që është shumë e rëndësishme. Unë nuk e përmenda shumë, por në studim ne e kemi theksuar se performanca dhe mënyra se si qytetarët e perceptojnë administratën publike është shumë e rëndësishme.

Pavarësisht debateve, ne si grup ekspertësh kemi hedhur idenë e disa mënyrave për ta promovuar integritetin në administratën publike, një çmim të integritetit, një çmim të performancës, por mund të ketë mekanizma nga më të ndryshmet. Pra, është e nevojshme që administrata publike, të paktën në gjykimin tonë si ekspertë, përkundër këtij procesi që ajo do të përballojë, dhe sapo ka filluar procesi negociator, që urojmë të jetë sa më i shpejtë, të përmyllet në kohë, por kush ka parasysh eksperiencën që kanë kaluar vende të tjera, di se është një proces i gjatë e i vështirë, me të cilin do të përballlet vetë administrata.

Nga kjo pikëpamje, këtë e kemi theksuar edhe në analizë, si një nga elementet që deri diku e cenon zbatueshmërinë e planeve të integritetit, por natyrisht edhe indikatorët e matjes që duhet të ketë një plan integriteti, të jetë e qartë çfarë se me çfarë elementesh, çfarë treguesish sasiore apo cilësore mund të identifikojë një institucion në fund të këtij plani, që i ka përmbushur detyrimet që i vijnë atij.

Kalojmë te pyetja tjetër metodologjia e vlerësimit, që përmendi Valbona. Unë jam në dijeni të punës që ka bërë fondacioni *Westminster* në lidhje me këto elemente, që janë praktika të njohura në shumë vende, për të ndaluar që në procesin e ligjbërjes ato që quhen ligje me porosi apo ligje sipas “kostumit të rrobaqepësit”, të cilat për hir të së vërtetës, në kushtet e sistemit të demokracisë liberale, pa marrë këtu pozitën e lektorit, por në thelb duhet të kemi parasysh diçka: sistemi që ne kemi prej 30 vjetësh, është një sistem që lëviz nëpërmjet interesave. Biznesi ka interesin e vet, politika ka interesin e vet, shumë grupe të tjera kanë interesa të ndryshme, që herë përputhen e herë jo, mënyra se si një mekanizëm, qoftë ky i ndërtuar, i thjeshtë, i saktë, por që do të ketë edhe një kontroll nga jashtë. Ajo çfarë kemi vënë re gjatë pjesë sonë, është fakti që shpeshherë njerëzit, pra qytetarët nuk është se kanë shumë mekanizma për të kontrolluar se si po shkon një proces. Pra, niveli i transparencës në administratën publike duhet të jetë më i lartë.

Për ta përmbyllur, do të thosha se ka shumë rëndësi që etika dhe integriteti në administratën publike të vijë nëpërmjet një formimi gradual dhe një ndërgjegjësimi që duhet të jetë i vazhdueshëm. Tashmë ne e dimë se të marrësh një ligj apo një kuadër normativ nga vendi më i zhvilluar i Europës dhe ta përafrosh me legjislacionin shqiptar, ndërkohë që do të kemi edhe ligje të gatshme, që s’do të kemi nevojë t’i përafrojmë, pra shumë rregullore e direktiva, por mënyra si do të lëvizë ndryshimi i mentalitetit brenda administratës publike është shumë e rëndësishme, dhe besoj se në lidhje me këtë kemi shumë sfida përpara. Nuk e di sa i qartë isha me përgjigjen time, por kjo ishte përgjigjja sipas këndvështrimit tim.

Faleminderit!

Ardian Haçaj – Zonja Aliaj, mbi analizën postlegjislative dhe mekanizmat efikasë shtrëngues për postpunësim e parapunësim.

Iris Aliaj – Në fakt, edhe në vijimësi të fjalës së zotit Kamberi, unë do të doja të ndalesha shkurtimisht te pjesa e planeve të integritetit. Të gjithë jemi në dijeni të faktit se për herë të parë planet e integritetit janë propozuar në strategjinë e vjetër ndërsektoriale kundër korrupsionit, të viteve 2015-2023 dhe kryesisht monitorimi i tyre zbatohet nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Nga ajo që ne kemi konstatuar nga analiza jonë është se nuk

analizohen faktorët që ndikojnë në mosrealizimin apo në realizimin pjesor të masave të përfshira në planet e integritetit.

Pra, raportimi ka natyrë më shumë sasiore se cilësore. Kësisoj, raportet e monitorimit të efikasitetit të planeve kanë konstatuar se rrezikojnë të jenë më shumë mjete deklarative, nëse nuk bazohen në të dhëna të sakta e të besueshme raportimi.

Këtë kisha si ndërhyrje lidhur me planin.

Faleminderit!

Ardian Haçaj – Në rregull!

Faleminderit!

Kemi edhe disa minuta kohë para se të kalojmë te prezantuesi tjetër.

Aleksander Maskvic – Kam një eksperiencë të gjerë për sa i përket legjislacionit apo rishikimit të legjislacionit. Në lidhje me këtë pozicion dëshiroj t'ju ofroj kapacitetet dhe kontributet tona për rishikimin e legjislacioneve të ndryshme, nëse do të jetë e nevojshme, sepse ne jemi në pjesën e legjislacionit që ka të bëjë me Parlamentin, me Kapitullin 25 në lidhje me përmbledhjen e dokumenteve që kanë të bëjnë me integritetin dhe etikën në administratën publike.

Duke iu referuar rekomandimeve, në mënyrë të shkurtër, dëshiroj të bëj një qartësim për sa i përket rekomandimit për deklarimin sa më efikas të pasurisë, për të cilin nevojiten struktura më të mira për të mbështetur implementimin efikas të procesit të deklarimit nga organet që janë të detyruara për të marrë këto deklarime, sqarimet e tyre, strukturat e ndryshme që ne i referohemi.

Për sa i përket krijimit të indikatorëve të performancës kyç është shumë mirë që të kuptohet se cilët janë aktorët e tjerë të jashtëm, ku ne duhet të referohemi dhe cilat janë situatat për punën e vlerësimit të performancës nga aktorët e tjerë. Në këndvështrimin tim këto janë ato që mund të përmendja.

Ju falënderoj!

Jam në pritje për të kontribuar për sa folëm.

Ardian Haçaj – Ju faleminderit shumë!

Puna e OSBE-së është shumë e vlefshme në të gjithë këtë sektor. Sipas njohurive të mia (më korrigjoni nëse e kam gabim) ky komision i posaçëm parlamentar është një nga iniciativat shumë të pakta që numërohen me gishtat e një dore, që është 100% pronë e shqiptarëve, e këtij vendi, siç e përmendi edhe zonja Ekonomi pak më parë.

Nga ana tjetër është parashikuar një linjëzim 100% me partnerët ndërkombëtarë, siç u vu re edhe nga kuotimet shumë të shpeshta që iu bënë dokumenteve, qoftë nga BE-ja, qoftë

nga GRECO-ja, USA-ja, OSBE-ja e të tjerë. Kështu që, në një hap të dytë, ekspertët e huaj janë të mirëseardhur për të punuar mbi dokumentin bazë që është prodhuar nga aktorët shqiptarë.

Me kaq mbyllim në orën 17:00 mbyllim prezantimin e parë.

Me kënaqësi të madhe kalojmë tek ofrimi i shërbimeve digjitale, ku profesore Migena Leskoviku, nga Instituti i Studimeve Europiane, do të bëjë prezantimin e dokumentit analitik.

Migena Leskoviku – Mirëdita!

Faleminderit për prezencën!

Në emër të grupit që përfaqësoj, që ka mbuluar Kapitullin IV të shtyllës së parë të mirëqeverisjes, ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara, do të prezantoj gjetjet dhe arritjet, në të njëjtën kohë edhe disa rekomandime dhe çështje për adresim mbi bazën e analizës që ne kemi bërë në kuadër të këtij kapitulli.

Kur bëhet fjalë për ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara duhet thënë që Shqipëria është vlerësuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë. Në mjaft raporte ndërkombëtare të BE-së, të SIGMA-s, të OKB-së, Shqipëria është vlerësuar në lidhje me transformimin e bërë në fushën e digjitalizimit të shërbimeve publike, madje aktualisht konsiderohet edhe në krye të rajonit për sa i përket transformimit digjital.

Aktualisht kemi 1227 shërbime publike elektronike, ose rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike *online*, gjë që tregon për një progres të rëndësishëm në këtë fushë. Ajo çka është konsideruar në kuadër të analizës që është bërë është se progresi i digjitalizimit në tërësi në Shqipëri ka arritur që, së pari, të lehtësojë proceset administrative, ka përmirësuar aksesin në shërbimet publike për qytetarët dhe bizneset, ka reduktuar kostot, radhët dhe ka bërë të mundur uljen e shpenzimeve për qytetarët, duke u llogaritur në një shumë prej rreth 12 milionësh. Në këtë kuadër, një histori suksesi është portali qeveritar *e-Albania*, i cili ka përmirësuar mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike dhe ndërkohë në kuadër dhe në vazhden e përmirësimit të ofrimit të këtyre shërbimeve planifikohet ristrukturimi dhe ridizenjimi i këtij portali dhe i shërbimeve që ai ofron. Po ashtu, vlen për t'u përmendur se aktualisht ka 63 regjistra elektronike të ndërveprueshëm, të cilët lejojnë dhe mundësojnë që rreth 68% e fushave të formularëve të aplikimit të plotësohen automatikisht. Kuptohet që në krye të gjithë procesit të digjitalizimit, për efekt të koordinimit dhe zbatimit, është një agjenci e rëndësishme, AKSHI, si institucioni kryesor në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve publike që u ofron qytetarëve, bizneseve dhe administratës publike në tërësi për shërbime të tilla *online*. Gjithashtu, duke iu referuar projekteve aktuale dhe angazhimit të qeverisë shqiptare në këtë drejtim, vlen të përmendet përdorimi i potencialit të inteligjencës artificiale dhe *big data*, me qëllim që të nxitet një qeverisje më efikase, më transparente dhe më e përgjegjshme në dobi të qytetarëve.

Kur bëhet fjalë sa i përket progresit dhe arritjeve, pikë së pari, në lidhje me kuadrin ligjor dhe dokumentet strategjike, që janë aktualisht në fuqi, në mënyrë të përmblendhur do të përmendja ligjin për qeverisjen elektronike, i miratuar në vitin 2023, i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike në lidhje me infrastrukturën e informacionit dhe sigurinë digjitale, dhe ndryshimet e këtij ligji të bëra në vitin 2024 parashikojnë ofrimin e shërbimit të nënshkrimit elektronik për shtetasit shqiptarë dhe për shtetasit e huaj. Po ashtu, është në fuqi, madje është vlerësuar edhe nga raporti *screening* dhe progresraporti i Bashkimit Europian, “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026”, në përputhje me deklaratën e Berlinit për shoqërinë digjitale dhe qeverisjen digjitale të bazuar në vlera, e cila ka si vizion të saj krijimin e shërbimeve digjitale gjithëpërfshirëse dhe pa kufij për qytetarët dhe bizneset. Në kuadër të dokumenteve strategjike, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe Strategjinë kombëtare të Sigurisë Kibernetike dhe planin e saj të veprimit, e cila synon që në tërësi të forcojë sistemet tona të sigurisë kibernetike, të zbulimit, por edhe të parandalimit të sulmeve kibernetike dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj incidenteve të mundshme, duke pasur parasysh edhe eksperiencën që ne patëm në korrik të vitit 2022, në kuadër të sulmeve kibernetike.

Së fundi, vlen të përmendim që me vendim të Këshillit të Ministrave në tetor të vitit 2023 është bërë e mundur që korniza kombëtare e ndërveprueshmërisë të jetë në përputhje të plotë me kornizën aktuale të ndërveprueshmërisë ose interoperabilitetit, që aktualisht është në fuqi nga Bashkimi Europian. Cilat janë elementet pozitive ose përmirësimet që ka sjellë digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve publike? Në vija të përmblendhura, sepse sigurisht që në analizën e bërë janë më gjerësisht, ky digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve publike ka mundësuar formalizim të ekonomisë dhe ka ndihmuar në fiskalizim; ka ndikuar në uljen e korrupsionit; ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë së të dhënave (këtu kemi parasysh edhe pjesën e dokumentacionit që shkëmbehet mes institucioneve të ndryshme publike për të shmangur vonesat ose gabimet njerëzore); uljen e të ardhurave të padeklaruara nga taksapaguesit, gjithashtu ka rritur kontributet sociale; garanton transparencë dhe llogaridhënie më të mirë, në të njëjtën kohë mundëson lëshimin e dokumenteve administrative me vulë elektronike apo nënshkrim elektronik, që janë të mundura që nga maji i vitit 2022.

Sigurisht, në qasje dhe prezantim, pa dashur të hyjmë shumë në elemente, janë edhe disa tregues kryesorë të këtij progresi dhe disa projekte në vijimësi në këtë drejtim, që synojnë nga njëra anë të vijnë me riinxhinierimin, si dhe të fillojë personalizimi i shërbimeve publike, përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të ofruara për publikun në format elektronik, duke rishikuar dhe duke thjeshtuar proceset e biznesit dhe përdorimin e gjerë të vulës elektronike

nga institucionet publike; shkëmbimin automatik të informacionit për llogaritë financiare, i cili ndihmon në uljen e të ardhurave të padeklaruara nga taksapaguesit dhe individët, gjithashtu është përmendur si një element pozitiv edhe tentativa, projektet aktuale që ka qeveria shqiptare, një projekt ambicioz do të thosha, për të integruar inteligjencën artificiale në sektorë të ndryshëm publikë, me qëllim transformimin e shërbimeve publike, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së tyre, në të njëjtën kohë edhe për të pasur një angazhim më të mirë të qytetarëve.

Përtej përmirësimeve, dhe e theksoj se në fushën e digjitalizimit Shqipëria mbetet në krye të rajonit, megjithatë mbeten disa elemente dhe disa fusha që kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme.

Në vija të përgjithshme ne i kemi identifikuar dhe ndarë në tri grupe.

E para, përmirësimet e mëtejshme nevojiten në infrastrukturën digjitale.

E dyta, në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

E treta, për mbështetjen e grupeve vulnerabël, me qëllim që këto përmirësime të sigurojnë se digjitalizimi të jetë gjithëpërfshirës dhe efektiv për të gjithë qytetarët. Duke thënë këtë, disa nga rekomandimet dhe çështjet për adresim, në kuadër të digjitalizimit dhe ofrimit të shërbimeve të digjitalizuara për qytetarët dhe bizneset, konsiston pikë së pari në konsolidimin e kuadrit ligjor për shërbimet digjitale, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave dhe harmonizimin e tij të plotë me legjislacionin e Bashkimit European. Këtu do të ndaleshim në dy momente: pjesa e legjislacionit që do të duhet të përputhet tashmë plotësisht me *acquis*-në e BE-së në fushën e sigurisë kibernetike dhe privatësisë së të dhënave, me qëllim që standardet në lidhje me shërbimet digjitale të ofruara nga administrata publike të krijojnë besueshmëri për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve dhe për të garantuar besimin e publikut në këto shërbime që ofrohen. Nga ana tjetër, përveç kësaj, lipset që të ndiqet trendi në përditësimin e akteve rregullatore të BE-së në fushën digjitale, ku këtu do të përmend dy momente të rëndësishme.

Së pari, akti i Europës së ndërveprueshme, i cili është miratuar në prill të vitit 2024, nga ana tjetër është rregullorja e-IDAS, e cila po punohet dhe po rishikohet aktualisht nga BE-ja, për të zhvilluar kuadrin teknik dhe rregullator në lidhje me portofolin e ardhshëm të identitetit digjital të BE-së. Pra, nga njëra anë është përditësimi dhe harmonizimi i plotë me legjislacionin e BE-së, nga ana tjetër është ndjekja e trendit të rregullimeve dhe kuadrit rregullator të BE-së për të qenë në koherencë me ndryshimet që BE-ja bën aktualisht në fushën e legjislacionit. Gjithashtu, është theksuar edhe në progresraportin e fundit të Bashkimit European nevoja për të forcuar ndërveprueshmërinë ose interoperabilitetin ndërkufitar përmes një kuadri kombëtar ndërveprueshmërie, si bazë për shërbimet publike digjitale ndërkufitare të ndërveprueshme me

në qendër njeriun, ose siç quhet ndryshe “*life events*”. Po në lidhje me legjislacionin vlen të përmendet harmonizimi i legjislacionit të posaçëm sektorial dhe aktet nënligjore me Kodin e Procedurave Administrative dhe zbatimi më i mirë i tij në praktikë. Aktualisht, siç është vërejtur edhe nga raportet, ky ritëm ka qenë i ngadaltë, ndaj edhe përditësimi i këtij legjislacioni me këtë kod do të bëjë të mundur thjeshtimin e procedurave administrative, me kosto administrative dhe barrë të reduktuar për qytetarët dhe bizneset, ndaj edhe ka një plan për rishikimin e legjislacionit sektorial dhe të akteve nënligjore në këtë drejtim.

Elementi tjetër lidhet me rritjen e aksesit në shërbimet digjitale në tërësi, posaçërisht në zonat rurale. Sigurisht, përmirësimet në ofrimin e shërbimeve digjitale për qytetarët janë të dukshme, megjithatë këto duhet të zhvillohen më tej për qytetarët dhe bizneset, për më tepër që në progresraportin e fundit të Bashkimit Europian del si rekomandim nevoja për të pasur një strategji gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve, që duhet të reflektohet gjithashtu në strategjinë e ardhshme të reformës në administratën publike, e cila po diskutohet dhe pritët të dalë së shpejti. Ndërkohë, po ashtu kërkohet një investim më i madh në infrastrukturën digjitale, veçanërisht kur bëhet fjalë për zona të largëta, me qëllim përmirësimin e qasjes në internet për të gjithë qytetarët, ku, krahas të tjerave, edhe aktorët lokalë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me përdorimin e platformave *online*, asistencën dhe trajnimet. Garantimi i aksesit të barabartë për të gjithë qytetarët kërkon rritjen e kapaciteteve administrative, në mënyrë që administrata t’u përgjigjet nevojave dhe trendit në rritje për digjitalizim. Këtu flasim jo vetëm për administratën në nivel qendror, por edhe për administratën në nivel lokal.

Përshtatja e platformave ekzistuese digjitale për grupe specifike me nevoja të veçanta është po ashtu një rekomandim tjetër, në mënyrë që këto platforma të jenë të aksesueshme dhe të përmbajnë opsione për përdoruesit me nevoja të veçanta, si audio-leximi, përkthimet në gjuhën e shenjave dhe opsionet për tekste të thjeshtuara. Gjithashtu, në kuadër të llogaridhënies, transparencës dhe të parandalimit të korrupsionit përmes digjitalizimit, synohet të forcohen sistemet e llogaridhënies, instrumentet e monitorimit, raportimit dhe ankimit për të pasur një administratë më të hapur dhe më të përgjegjshme. Ndërveprimi mes aktorëve publikë dhe sektorit privat mbetet po ashtu një element tjetër që duhet të merret në konsideratë dhe të zgjerohet, veçanërisht kur kemi parasysh kompani teknologjike dhe organizata të biznesit që mund ta përshpejtojnë decentralizimin e shërbimeve dhe rritjen e cilësisë së tyre.

Një element tjetër lidhet me të drejtat pronësore, regjistrimin dhe digjitalizimin e të dhënave kadastrale. Ky është një proces, i cili ka vijuar, por, siç theksohet në raportet e progresit të BE-së, me ritme të ngadalta, ndaj nevojitet alokimi i burimeve të mjaftueshme dhe

finalizimi i kornizës ligjore për të përfunduar proceset kalimtare në fushën e të drejtave pronësore dhe për të përmirësuar transparencën dhe cilësinë e regjistrimit të pronave.

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, lidhet me rritjen e ndërgjegjësimit për shërbimet *online* dhe edukimin digjital, me qëllim që ndërgjegjësimi dhe ky edukim digjital të kontribuojë për përdorimin më të gjerë dhe më efektiv të shërbimeve publike *online*, veçanërisht për grupet më vulnerabël, të cilët kanë më pak akses ose aftësi për të përdorur këto shërbime dhe të rritë ndërgjegjësimin për rolin e digjitalizimit dhe për një integrim më të gjerë të platformave digjitale. Ky është prezantimi në vija të përgjithshme. Ndërkohë, keni edhe disa teza për diskutim publik, që ne si grup pune kemi ngritur në lidhje me kapitullin e digjitalizimit.

Ju faleminderit! Mbetemi të hapur për komente dhe diskutime!

Ardian Haçkaj – Shumë faleminderit për qasjen e strukturuar dhe, mbi të gjitha, për mënyrën koncize se si ky grup ka trajtuar një temë që është transversale, e cila prek kuadrin ligjor, konsolidimin dhe harmonizimin me BE-në, harmonizimin me Kodin e Procedurave Administrative, që është edhe mënyra se si ky mund të implementohet; zbatimin; zhvillimin dhe mbulimin e territorit, që sapo e përmendët; gjithashtu, edhe qasjen sociale, duke u dhënë mundësi grupeve vulnerabël që të kenë qasje të barabartë, duke përfshirë edhe sektorin privat!

Koha për pyetje, pyetje dhe diskutime për këtë temë kaq të gjerë.

E ftuar – Përsëndetje....

(Ndërprerje e regjistrimit)

...publike, si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel qendror.

Faleminderit!

Ardian Haçkaj – Faleminderit!

Pyetje tjetër?

Po.

Drisid Malaj – Mirëmbërëma!

Faleminderit!

Jam Drisid Malaj, student i nivelit të dytë master pranë Institutit të Studimeve Europiane, dega Legjislacion. Kam një pyetje, duke u nisur edhe nga ndryshimet teknologjike, siç është inteligjenca artificiale, si do të përfshihet inteligjenca artificiale në përmirësimin e shërbimeve publike dhe përdorimin e saj?

Faleminderit!

Ardian Haçkaj – Pyetje tjetër.

Donjet Gjokaj – Përsëndetje! Jam Donjet Gjokaj nga UNDP-ja. Ju falënderoj për mundësinë e pjesëmarrjes në këtë tryezë! Do të doja të bëja një pyetje në lidhje me një sërë

rekomandimesh që pamë, që burojnë si pjesë e progresraportit apo e dokumenteve të tjera. Normalisht grupet e punës, që kanë punuar për procesin *screening*, ndër të tjera kanë hartuar edhe disa vakume institucionale dhe administrative për sa i përket aftësisë së vendit për t'u përafruar me legjislacionin e BE-së, e quajtur ndryshe si LGA dhe IAGA. Do të doja të dija nëse janë marrë parasysh këto dokumente për hartimin e këtyre rekomandimeve.

Faleminderit!

Ardian Haçkaj – Në qoftë se ju kuptova drejt, ju kërkoni të dini nëse konkluzionet e procesit *screening* janë marrë parasysh nga grupi i ekspertëve, qoftë nga zonja Leskoviku, zonja Aliaj apo zoti Kamberi në përgjithësi, apo vetëm për zonjën Leskoviku për digjitalizimin.

Donjet Gjokaj – E kisha më shumë për sa u përket rekomandimeve që burojnë qoftë për ngritje apo ndryshime administrative, por edhe për ndryshime që kanë të bëjnë edhe me reformimin e disa institucioneve, por edhe me përfshirjen e risive, të cilat kërkojnë resurse administrative, njerëzore, por edhe institucionale dhe secili kapitull, në kuadër të procesit të integritetit, specifikisht në kuadër të procesit *screening*, ka pasur si “ushtrim” hartimin e “*legal gap analysis*” dhe “*institutional administrative gap analysis*” dhe nëse janë marrë këto dokumente në konsideratë për hartimin e rekomandimeve.

Ardian Haçkaj – Në rregull, pyetja është për të 3 ekspertët.

Atëherë, profesori për matjen e aftësive digjitale në administratën publike, përfshirjen e inteligjencës artificiale në ofrimin e shërbimeve publike dhe pyetja e tretë për të 3 kolegët.

Migena Leskoviku – Faleminderit për pyetjet!

Në lidhje me pyetjen e parë, do të thosha po, patjetër, siç e përmendëm edhe ne, çështja e forcimit të kapaciteteve në fushën e administratës kërkon domosdoshmërisht që t'i përgjigjet trendit në rritje të digjitalizimit. Kështu që, për këtë pjesë, pa dyshim që janë marrë parasysh edhe vështirësitë ose *gap*-i që mund të ketë pasur administrata publike, ku jemi referuar të dhënave të ndryshme të INSTAT-it në këtë drejtim, në të njëjtën kohë kemi pasur parasysh jo vetëm ato që kanë të përcaktuara progresraportet e ndryshme të BE-së apo raportet e ndërkombëtarëve për trajnimin e vazhdueshëm dhe rritjen e këtyre kapaciteteve në fushën e digjitalizimit, por edhe kurrikulën e ASPA-s, që kontribuon, gjithashtu, në trajnimin e nëpunësve në administratën publike dhe më gjerë.

Në lidhje me pyetjen tjetër se si do të përfshihet inteligjenca artificiale në shërbimet publike, sigurisht, është një pyetje shumë interesante. Ky është një projekt ambicioz, i cili aktualisht duket se do të aplikohet në një sërë shërbimesh publike, për shembull, mendohet të aplikohet: në transpozimin *acquis*, pra të legjislacionit të BE-së me legjislacionin shqiptar, ku inteligjenca artificiale do ta përshpejtojë këtë proces dhe përkthimin e dokumentacionit; në

fushën e prokurimeve publike; në fushën e shëndetësisë, po ashtu do të lehtësojë çështje që kanë të bëjnë me përdorimin dhe zbulimin e anomalive tek të dhënat dhe faturat e tatimeve dhe doganave. Pra, janë një sërë fushash ku inteligjenca artificiale mendohet se do të kontribuojë për përmirësimin e shërbimeve publike, sigurisht, edhe për ofrimin më efektiv të këtyre shërbimeve për qytetarët.

E fundit, për sa më takon mua, në emër të grupit, por edhe së bashku, sigurisht që raportet kryesore të organizatave ndërkombëtare janë marrë parasysh në lidhje me rekomandimet sa u përket çështjeve, që kanë të bëjnë me harmonizimin e legjislacionit dhe çështjeve që kanë të bëjnë me kapacitetet institucionale, kanë qenë pikë referimi dhe pjesë e metodologjisë, si dhe një udhërrëfyes i mirë për të parë avancimin, në të njëjtën kohë edhe boshllëqet dhe ku është e nevojshme për të ndërhyrë. Pra, nga ana e grupit tonë janë marrë parasysh në çdo rast ato që janë gjetjet dhe rekomandimet e BE-së, duke përfshirë edhe progresraportin e fundit të BE-së, i dalë në tetor të vitit 2024 për sa i përket kapitullit tonë në lidhje me përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike të digjitalizuara.

Iris Aliaj – Doja ta falënderoja zotin Gjoka për pyetjen.

Patjetër, progresraportet e çdo dokumenti të BE-së, tre udhërrëfyesit, e miratuar nga shteti shqiptar, gjithashtu, raportet e tjera vendase, të cilat janë prodhuar nga organizatat, si ato ndërkombëtare, ashtu edhe ato të vendit tonë, janë mbajtur në konsideratë në të gjithë analizën që ne kemi realizuar. Pra, edhe në pjesën e gjetjeve, kjo është e ndërlidhur edhe me rekomandimet që kemi dhënë.

Prezantimi që unë pata sot ishte i fragmentuar. Unë u mundova që të referohesha te gjetjet dhe te pjesa e rekomandimeve të progresraporti, sidomos tek ai i fundit, duke qenë se u prezantua para pak ditësh, por, nga ana tjetër, ky është një studim shumë voluminoz, pra nuk është vetëm kaq. Në ditët në vijim ju do të keni mundësi të merrni pjesë edhe në tryezat e tjera, që lidhen me shtyllën e dytë të antikorrupsionit. Aty do të shikoni se si janë parashikuar të gjitha rekomandimet që japin progresraportet, raportet ndërkombëtare dhe ato vendase në sugjerimet që ne kemi dhënë, propozimet për ndryshime, pra cilat janë masat e nevojshme për të luftuar korrupsionin.

I ftuar - Shumë shkurt edhe unë, në vijim të kolegëve, duke u nisur nga pyetja që bëri zoti Gjoka, është e vërtetë që brenda metodologjisë sonë të dokumentit analitik ka qenë shqyrtimi i të gjitha raporteve dhe të gjitha dokumenteve të tjera, që janë prodhuar nga organizata ndërkombëtare, vendase apo edhe institucionet shtetërore.

Në fakt, tek ajo që iu referuat pak më parë, pra vlerësimi boshllëqeve ligjore apo boshllëqeve administrative, që është pjesë e raportit të skanimit, BE-ja ka bërë një raport të

gjerë, të detajuar dhe ne nuk kemi dashur, të them të drejtën, të përsërisim apo t'i mbivendosemi atij raporti, por jemi përpjekur të evidentojmë disa rekomandime apo gjetje, të cilat mund ta ndihmojnë komisionin për ta parë, pra, si të thuash, kemi vënë kamerën për ta zmadhuar atë fenomen e të tjerë.

Për t'iu kthyer pjesës së digjitalizimit, meqenëse para dy vjetësh kam qenë autor i një studimi vetëm për këtë pjesë, për pjesën e digjitalizimit dhe rolit që ka pasur digjitalizimi dhe inovacioni në administratën publike, unë gjykoj që, ndoshta edhe për politikëbërësit dhe ligjbërësit, duhet të kenë kujdes të mos bien viktimë e faktit që digjitalizimi zgjidh diçka. Digjitalizimi zgjidh disa shërbime, që janë të karakterit administrativ, si: aplikimi për leje, për licenca, për dokumente, e të tjera. Qytetarët shqiptarë, dhe besoj se këta që janë deputetë dhe ligjvënës, që janë përditë në kontakt me elektoratin e tyre dhe me qytetarët, e dinë se ajo që vlen për qytetarin nga pikëpamja e administrimit publik është administrimi i territorit, shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, infrastrukture.

Sa i përket sigurisë dhe drejtësisë, përgjithësisht ne nuk e kemi konceptin që sigurinë dhe drejtësinë t'i shohim si shërbime, i shohim si autoritete që na fusin në burg ose na nxjerrin nga burgu. Në përgjithësi modeli perëndimor është që siguria dhe drejtësia janë shërbime. Pra, policia, prokuroria, gjykatat, janë institucione, të cilat shërbejnë, sepse paguhen me taksat e qytetarëve, në një demokraci funksionale, dhe si të tilla duhet të shihen, pra çfarë arrijnë ata, çfarë shërbimesh ofrojnë ata në kohë, në hapësirë dhe në cilësi. Kjo besoj do të jetë edhe fryma që do të përbëjë dokumenti analitik.

Faleminderit!

Migena Leskoviku - Edhe diçka të fundit, që më mbeti pa thënë tek inteligjenca artificiale, aktualisht në portalin “e-Albania” nga dhjetori i vitit 2023 është prezantuar asistenti virtual, i cili u përgjigjet pyetjeve. Vlerësohet se janë mbi 900 mijë pyetje të drejtuara nga qytetarët, ndërkohë që, me përditësimin e platformës “e-Albania” dhe përfshirjen e asistentit të ri virtual, do të bëhet e mundur që të përmirësohet ky shërbim, në kuadër të asaj që quhet *life event*, që kohë kjo asistencë të vijë me zë dhe me figurë.

I ftuar - Edhe një koment, në vijim të kësaj që tha Migena për inteligjencën artificiale. Sot në BE, ku Shqipëria po bëhet gati të hyjë, një nga treguesit që lidhet me rëndësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale është përdorimi i këtij elementi për të krijuar një politikë që mbështetet mbi të dhëna. Pra, nuk ka kuptim që administrata publike të marrë dhe të përdorë aplikacionet e inteligjencës artificiale në momentin që ata nuk arrijnë të prodhojnë të dhëna për politikëbërësit në kohë reale. Pra, nëse në kushte normale do të duhej një muaj apo edhe më shumë për të nxjerrë një të dhënë, teknikat e inteligjencës artificiale sot arrijnë të përpunojnë

miliona të dhëna për të nxjerrë tregues që i shërbejnë politikëbërjes. Besoj se ky do të jetë edhe një nga qëllimet, ose gjykoj të paktën, që duhet t'i shtyjë institucionet shtetërore që zhvillimin teknologjik ta vendosë në funksion të politikëbërjes dhe qeverisjes së mirë.

Ardian Haçaj - - Është shumë interesante përmendja e termi politikëbërje gjatë kësaj seance, që në vlerësimin tim, shumë modest, tregon një shtrirje të punës dhe të fushës së veprimit të kësaj pune, përtej aktit normativ apo përafrimit me *acquis* dhe harmonizimin.

Një raund të dytë pyetjesh dhe përgjigjesh.

Juelda Lamçe – Përsëndetje, quhem Juelda Lamçe, dekan e Fakultetit të Shkencave Politike, Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Europian të Tiranës.

Kam një pyetje për sa kohë teknologjia është një nga sfidat jo vetëm për Shqipërinë, por për mbarë botën. Në analizën tuaj a i keni përmendur risqet që sjell përdorimi i teknologjisë dhe një kostim të ndërhyrjeve?

Faleminderit!

Ardian Haçaj - - A ka pyetje apo koment tjetër?

Me sa duket po i afrohem fundit.

Migena Leskoviku - Sa u përket risqeve, unë e përmenda, digjitalizimi duhet të shkojë në krah të forcimit të parametrave të sigurisë kibernetike, nga njëra anë, të infrastrukturës digjitale, sigurisht, për efekt të mbrojtjes së të dhënave personale. Kështu që, edhe në ridizenjimin e platformës ekzistuese “e-Albania”, është pasur parasysh pikërisht përforcimi i këtyre parametrave, në përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi, që është korniza kombëtare e ndërveprueshmërisë dhe ligji për qeverisjen elektronike, i cili tashmë i ka kaluar shërbimet publike vetëm *online*, jo përmes kontaktit fizik, duke pasur parasysh edhe infrastrukturën e nevojshme në këtë drejtim.

Për sa i përket kostimit, nuk ka qenë pjesë e punës sonë, sepse kostimi është një çështje që, duke qenë se edhe vetë qeveria në VKM-në e saj, për efekt të udhërrëfyesit për administratën publike 2023-2030, çështjet që kanë të bëjnë me përditësimin e kornizës aktuale në fushën digjitale, dhe këtu i referohem Aktit të Europës së Ndërveprueshme dhe Rregullores së BE-së, e-IDAS, që po rishiokohet, nuk ka vënë një afat, por ka thënë pas rishikimit. Kjo do të thotë që udhërrëfyesi e ri, ndër të tjera, dhe në planin e veprimit sigurisht do të merren parasysh edhe kostimi sa u përket këtyre parametrave të sigurisë digjitale dhe infrastrukturës digjitale.

Faleminderit!

Person M - Në vijim të pyetjes që bëri zonja Lamçe, në fakt, kjo fazë ku ne jemi përfshirë, si ekspertë, ka të bëjë me realizimin e dokumentit analitik, që, siç u përmend pak më

parë, ka bërë një fotografim të situatës, që lidhet me të tria shtyllat: mirëqeverisjenm sundimin e ligjit dhe antikorruptionin. Sot ne ishim për shtyllat që lidhen me mirëqeverisjen.

Sa i përket asaj që thatë ju, qoftë për rreziqet apo për kostimin, që lidhen me teknologjitë e reja të informacionit, përfshirë edhe zbatimet e inteligjencës artificiale, besoj se në planin e veprimit, që do të shoqërojë dokumentin analitik, dhe që do të jetë plan pune i Parlamentit shqiptar dhe i qeverisë shqiptare, qoftë edhe si rekomandim që vjen nga ana juaj, do të përfshihet pikërisht hartimi i planeve të veprimit për zbatimet e inteligjencës artificiale, përfshirë risqet, por edhe kostot që do të ketë ky proces, dhe ndoshta Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, që është agjenci e specializuar, besoj se do të punojë në këtë drejtim.

Migena Leskoviku - E fundit dhe do ta mbyll, sigurisht ne duke pasur parasysh edhe kontributin e AKSHI-t në këtë drejtim, që është dhe institucioni kryesor, siç e përmenda, jemi informuar për projektet e reja që janë aktualisht *on going*, pra që po zhvillohen në këtë fushë me ndihmën dhe asistencën edhe të ekspertëve ndërkombëtare dhe të ekspertëve të mikrososfrit. Kështu që, përditësim dhe sapo këto projekte të zbatohen, pa dyshim, ne do të kemi edhe një panoramë më të qartë në këtë drejtim, përtej çështjes që lidhet me përditësimin e udhërrëfyesit, strategjinë e re të reformës në administratën publike, sigurisht edhe planin e veprimit që do të shoqërojë këtë dokument që do të prodhojë Kuvendi.

Ardian Haçaj - – Zonja Karçanaj mund të japë më tepër informacione.

Mirlinda Karçanaj – Unë jam Mirlinda Karçanaj, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Unë ju falënderoj për punën, është impresionuese! Zakonisht jemi ne të AKSHI-it që nuk ia lëmë fjalën tjetrit, në rastin konkret, ishte e kundërta.

Doja të jepja disa sqarime shumë shkurt, pa marrë kohë. Për sa i përket e-IDAS, dua të theksoj që ofrimi i shërbimit të nënshkrimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, aktualisht janë të certifikuar me e-IDAS 1, e-IDAS 2 sapo është miratuar për vendet e BE, dhe ato kanë deri në 2027-ën, në fund, kohë që të përshtatin infrastrukturën dhe mënyrën se si e ofrojnë shërbimin e besuar. Por ne jemi duke ecur paralelisht edhe me të qenit konfront me e-IDAS 2 në zhvillimit e reja që kemi bërë në platformën e shërbimeve të besuara.

Gjithashtu, doja të theksoja punën që është bërë për riinxhinierizimin. Besoj se drejtoreshat e portalit, Nevila dhe Romina, kanë sqaruar që ne jemi ulur për muaj të tërë me çdo institucion, duke e kaluar shërbimin një nga një, në mënyrë që të thjeshtohen dokumentet shoqëruese, në mënyrë që të thjeshtohet çdo formë e aplikimit, që nganjëherë institucionet u bien edhe për shkurt, thonë “*attach*” një dokument, dhe pastaj dokumenti brenda është një

nightmare për t'u plotësuar etj. Pra, në njëfarë mënyre ne i kemi shkuar çdo shërbimi nga fillimi deri në fund, duke pasur pikësynim kursimin e kohës dhe thjeshtimin e dokumentacionit.

Besoj se informacioni është i qartë edhe për dokumentet shoqëruese shtet me shtet. Që nga viti 2020 nuk ekzistojnë më barrë për qytetarin apo biznesin dokumentet që lëshohen nga shteti. Ne kemi një platformë të dedikuar me nënshkrim elektronik, ku të gjitha institucionet publike shkëmbejnë mes tyre dokumentet shoqërues *on behalf* të qytetarit ose biznesit. Për ta përdorur këtë platformë janë mbi 10 mijë punonjës të administratës publike, të trajnuar në mënyrë të dedikuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Stafit që ka AKSHI pranë çdo institucioni, përveç trajnimit të qendërzuar, ju bën në mënyrë të vazhdueshme trajnime të dedikuara stafit ekzistues apo stafit të ri.

Çdo sistem digjital shoqërohet edhe me trajnim të plotë të trajnuesve, të cilët pastaj trajnojnë përdorues të nivelit më të ulët.

Lidhur me projektet që kemi në plan apo që po implementojmë me Bankën Botërore, është transformimi i platformës “e-Albania”. Ne e dimë që teknologjia lëviz jashtëzakonisht shpejt dhe ne nuk mund të mbetemi peng i një platforme të implementuar 9 vjet më parë. Shërbimet, gjithashtu, do të rishikohen në formën e mikroserviseve, që të mos të kemi më shërbime të mbetura peng në hallkat të caktuara. Mikroservisi të bën të mundur që të kërkosim shërbimin, kërkesa të mbetet në një status të caktuar nëse ke një problem në *back-end* apo një problem në konektivitet. *Life event*-et janë konceptuar vërtet në mënyrën më të përshtatshme të mundshme. Kemi pasur ekspertizën e Bankës Botërore, të them të drejtën, ata na kanë vendosur në dispozicion ekspertët e tyre më të mirë, të Estonisë, të Danimarkës, që janë shumë i specializuar edhe në *GDPR*.

Përdorimi i inteligjencës artificiale, në shtator të këtij viti ne miratuam një vendim të Këshillit të Ministrave metodologjinë dhe rregullat e përdorimit të sigurt dhe të besueshëm të inteligjencës artificiale. Do të kalojmë edhe në miratimin e strategjisë së inteligjencës artificiale, kemi një dokument të formësuar tashmë, me të cilin po punojmë jo vetëm me institucionet por edhe me Microsoft-in, edhe me partnerët e tjerë që ky dokument të miratohet shumë shpejt.

Lidhur me ofrimin e shërbimeve për personat vulnerabël, përveçse kemi marrë një ekspertizë të dedikuar nga Banka Botërore, planifikojmë që të gjitha qendrat ekzistuese, ADISA, t'i kthejmë në qendrat e ofrimit të shërbimeve, por edhe të përdorimit të asaj që ne e quajmë *omnichannel*, ku kërkesa për ndihmë e qytetarëve dhe ndjekja e shërbimit deri në marrjen e tij të kalojë në një zinxhir, që fillon me inteligjencën artificiale, kalon pastaj në *help*

desk me tick të caktuara dhe në fund mund të terminojë edhe në një *call center*, ku kemi një ofrues të qartë shërbimi, ndjesë po zgjatëm.

Kurse në projektet me inteligjencë artificiale është transpozimi i akteve të EU-së, i cili definohet jo vetëm në përkthim, por edhe në krijimin e tabelave të konkordancës, pra ne do të kemi tabela të qarta, të cilat na japin një mundësi që të shikojmë se çfarë ndryshimesh duhet të bëjë legjislacioni ynë, në mënyrë që të transpozohet konform direktivave të BE-së.

Unë jam bashkënegociatore për Kapitullin 10 dhe ju siguroj që të gjitha aktet janë analizuar. Ne, me vendim të Këshillit të Ministrave, shpejt do të kemi edhe *framework*-un e interoperabilitetit, të miratuar në nivelin më të lartë të mundshëm, vendimit të Këshillit të Ministrave.

Faleminderit!

Ardian Haçaj - – Shumë faleminderit, zonja Karçanaj!

Është me të vërtetë shumë interesant ky ndërveprim i një agjencie shtetërore dhe një komisioni *ad hoc* në një event ku janë aktorë të shoqërisë civile, të cilët paraqesin dokumentin e tyre analitik.

Po ndaloj këtu, meqenëse kemi arritur edhe afatet kohore, për t'ju bërë një përmbledhje ose një reagim të parë të ekspertëve që kanë prezantuar dokumentin analitik dhe më pas për t'ia lënë fjalën zonjës Ekonomi, për të bërë përmbledhjen e këtij eventi dhe për të treguar edhe hapat e ardhshëm ku do të kalojë ky konsultim.

Fillojmë me ju, zonjë.

Femër – Faleminderit!

Para se të filloja, do të doja të sqaroja diçka që më ngeli merak për një diskutim që ngriti zonja Kuko në lidhje me çështjen e *post-scrutiny*. Në fakt, ne nuk kemi arritur të gjejmë një analizë të tillë, edhe pse kjo është në përgjegjësinë e Kuvendit. Në lidhje me çështjen që ju trajtuat për konfliktin e interesit, të dhënat nuk janë publike për administratën publike, sidomos në nivelin e lartë drejtues, pra nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna sasiore në lidhje me këtë çështje, por analiza jonë është fokusuar në konfliktin e interesit në tërësi, ku komponentin i parë i antikorrupsionit përfshin edhe të zgjedhurit, edhe funksionarët e lartë duke i parë më vete, duke i parë në një qasje më të integruar me njëri-tjetrin.

Unë ju shpreh mirënjohjen dhe falënderimet që isha pjesë e kësaj tryeze, si dhe për të gjitha sugjerimet dhe diskutimet që ju parashtruat!

Pa diskutim që në hapat vijues ne do të mbledhim me grupin e ekspertëve dhe do të reflektojmë të gjitha diskutimet dhe sugjerimet në analizën që kemi realizuar deri tani, me

qëllim që të kemi një analizë përfundimtare të bazuar në të gjitha raportet që janë në shtyllën e antikorrupsionit.

Faleminderit!

E ftuar– Duke ju falënderuar për këtë prezantim si pjesë e tryezave publike në kuadër të të gjithë hapave që po ndjek ky komision i posaçëm, doja së pari të falënderoja anëtarët e grupit të punës, sekretariatit e Kuvendit, institucionet që kanë bashkëpunuar me ne për të nxjerrë një material, i cili është i plotë, por, sigurisht, nuk mund të ezauronim çdo gjë në këtë tryezë dhe brenda kësaj kohe të limituar, por në kuadër të digjitalizimit, digjitalizimi është një nga prioritetet, është një nga pikat e forta të qeverisë dhe, pa dyshim, zë një vend të rëndësishëm në reformën në administratën publike dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, ndaj ne në këtë drejtim do të ndjekim edhe ndryshimet më të fundit pikërisht për të parë edhe ecurinë në vijim të këtij procesi.

Gjej rastin të falënderoj edhe deputetët e shtyllës sonë të mirëqeverisjes për komoditetin, për bashkëpunimin dhe për lehtësitë që na kanë krijuar gjatë kësaj pune.

Ju faleminderit!

I ftuar - Në vijim të atyre që thanë kolegët, edhe unë do të gjej rastin, së pari, t'ju falënderoj ju për pjesëmarrjen, por edhe për mundësinë për t'u përfshirë në këtë vlerësim të një prej shtyllave më të rëndësishme të aspektit që lidhet me finalizimin e një ëndrre, që po bëhet gati 40 vjet, siç është anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian. Natyrisht, ne jemi të vetëdijshëm se kjo që ne po bëjmë është thjesht një gur i vogël brenda një muri të madh, i cili do të ndërtohet gradualisht.

Në pjesën që lidhet me etikën dhe integritetin e administratës publike ne jemi përpjekur të evidentojmë disa prej elementeve. Këtu shoh që ka përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike, që e njohin shumë mirë, dhe më vjen mirë që Kela ka vite që punon në administratën publike dhe besoj se është shumë e vetëdijshme për sfidat që ka pasur, ka dhe do të ketë administrata, sepse është një proces që do të jetë i vazhdueshëm.

Ajo që unë doja të theksoja, është ajo që unë e përmenda pak më parë: etika dhe integriteti i administratës publike në gjykimin tim si ekspert, por edhe si qytetar, është se çfarë perceptojnë qytetarët që përballen përditë me të. Pra, ne do të kemi një administratë që do t'u shërbejë qytetarëve shqiptarë, por pas disa vitesh do t'u shërbejë edhe qytetarëve europianë, të cilët do ta shohin Shqipërisë si pjesë të një tregu të përbashkët, pjesë të Unionit Europian. Pra, në këtë pikëpamje duhet filluar që tani të ngrihet një strategji apo ngrehina që do ta bëjë atë administratë të duket pjesë e hapësirës administrative Europiane, siç është termi që përmendet sot në BE.

Ju falënderoj edhe një herë dhe mirëpres, pavarësisht këtij takimi, secili në mënyrë elektronike, Besarta këtu, çdo koment, çdo sugjerim kritik, që do ta na ndihmonte shumë më tepër.

Faleminderit për çdo gjë!

Zonja Ekonomi, fjala e mbylljes.

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë!

Unë edhe një herë dua të falënderoj të gjithë ekspertët që punuan për të filluar procesin e tryezave.

Ne, në fakt, në komision, nën udhëheqjen e zotit Xhafaj, jemi mbledhur dhe vetë ne e kemi orientuar procesin, por ne nuk jemi hartues të dokumenteve, ne jemi vetëm drejtues të një procesi. Ky proces, që ka qenë pak i heshtur vetëm me ekspertë të nivelit të lartë, është bërë pak më publik me këto tryeza dhe ne kemi parashikuar që do të kemi 12 tryeza të tilla, të cilat do të jenë të hapura dhe, siç e pamë edhe sot, do të ftohen pjesëmarrës nga shoqëria civile, nga bota akademike, nga institucionet e pavarura dhe nga shoqata të ndryshme të biznesit. Ndërkohë, ne drejtojmë shtylla dhe jemi në këtë rast dëgjues dhe mbajtës shënimesh. Unë kam mbajtur disa shënime dhe ato shënime dua të ndaj me ju. Nga ana tjetër, në këtë proces që është i hapur, ju shikoni që në krye të sallës ne kemi një poster, ku tregohet edhe adresa e faqes *web*, që e kemi krijuar për këtë komision të posaçëm. Kjo faqe është e hapur për të dhënë çdo koment. Aty në mënyrë transparente tregohet për çdo mbledhje dhe janë procesverbalet dhe dokumentet që miraton komisioni i posaçëm, por ndërveprimi me publikun lejohet të bëhet nëpërmjet hapësirave që ka faqja *web*. Kështu, ata që kanë ide, mbase shikojnë dokumentet, duan të kontribuojnë me disa gjetje që kanë menduar se i bëjnë mirë këtij procesi, janë të ftuar të shkruajnë në këtë adresë, sikurse edhe mund të shkruajnë në adresën e *emel*-it të komisionit, ose në adresën e *email*-it të sekretariatit.

Përveç këtij momenti, që është proces i Kuvendit, i kuvendimit qendror, që ne e bëjmë këtu në selinë e Kuvendit, ne kemi menduar që do të ishte e udhës të bënim një udhëtim në Shqipëri dhe ky udhëtim të bëhej pranë universiteteve, ku është themeluar dhe ekziston mendimi kritik qytetar në plot njësi të qeverisjes vendore, ku ne t'i parashatrojmë edhe gjetjet që do të dalin nga tryeza e sotme dhe pastaj ta bëjmë pak më të hapur dialogun me publikun në lidhje me tre shtyllat kryesore të komisionit të posaçëm: mirëqeverisja, antikorrupsioni dhe sundimi i ligjit.

Nga ana tjetër, për ne është, gjithashtu, e rëndësishme që në këtë proces pune të ndjekim me shumë kujdes thirrjen e ekspertizës ndërkombëtare. Në fakt, disa nga ne, që jemi anëtarë të komisionit, në grupe të ndryshme kemi pasur rastin të komunikojmë me ekspertë të

organizatave të ndryshme ndërkombëtare, për shembull, me delegacionin e BE-së, me Bankën Botërore, me UNDP-në, dhe kemi parë prej tyre angazhime të vërteta lidhur me ekspertët që mund të na shoqërojnë ne në disa pyetje që mund të kemi, sepse kemi nevojë për të kuptuar më thellë një çështje që del nga diskutimi në tryeza. Unë dhe Etilda kemi pasur rastin të kontaktojmë me Bankën Botërore, që edhe për të ky procesi pati pak nevojë për një shpjegim më të thellë se çfarë prisnim ne nga ata. Edhe ne morëm kohën tonë, edhe ata morën kohën e tyre dhe sot i kemi pranë me një listë ekspertësh, që mund të na sigurojnë që të kemi një asistencë teknike për çështje që do të kemi nevojë për shpjegim të mëtejshëm, ose të na vënë në dispozicion dokumente të ndryshme, sepse vende të ndryshme kanë eksperiencë të ndryshme sesi mund ta bëjnë sundimin e ligjit më efikas ose luftën kundër korrupsionit më efikase, ke stade globale që janë shumë të mira edhe për t'u përdorur nga Shqipëria.

Gjithashtu, nga ana tjetër unë dua të vë në dukje që ndërkohë që grupi i ekspertëve punonte, besoj se ndaj me grupin e ekspertëve edhe dy shqetësime që ata kishin: e para që janë disa dokumentet që nuk ishin të vlefshme në momentin kur grupi i ekspertëve punonte, siç është rasti i progres raportit. Ky rast është shembulli tipik që prodhimi i progres raportit mbaroi më pas sesa grupi i ekspertëve kishte bërë analizën e parë. Besoj do të ketë nevojë që grupi i ekspertëve pasi të marrë edhe komentet që po vijnë nga tryezat t'i reflektojë edhe komentet, edhe gjetjet që janë më të përditësuara të progresraportit ose të raporteve të tjera, siç mund të jetë raporti i SIGMA-s, ose raporti i PEFA-s.

Patëm një problem me raportin e PEFA-s, sepse të dhënat që ne disponojmë për ta vënë pjesë të një prej tryezave që do të kemi në vijim, ishin të dhënat e vitit 2022, ndërkohë kur mbaroi raporti i ekspertëve, PEFA bëri një raport me të dhënat për vitin 2023. Do të kemi nevojë vazhdimisht për të përditësuar të dhënat më të fundit. Ky do të jetë një proces që nuk do të mbarojë kurrë, por në këtë moment kemi në dorë për të bërë këtë lloj përditësimi. Do përdorim këto tre elemente, që janë shumë të rëndësishme për ne.

Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme të vendosim edhe një fakt tjetër, që ky është një proces që na takon ne shqiptarëve dhe është shumë e rëndësishme që ne këtu të kemi edhe mendime kritike që vijnë edhe nga opozita. Edhe pse opozita nuk është ulur këtu, ka plot organizata të tjera të shoqërisë civile që kanë mendime dhe sugjerime të ndryshme. Ne kemi pasur fatin që këto organizatat, që janë kritike ndaj qeverisë, në këtë proces të kenë qenë të ulura në tryezë e të japin mendimet e tyre. Një pjesë e tyre në dokumentet që janë prodhuar, janë reflektuar si opinione të shoqërisë civile, është *watchdog*-i u qeverisë. Thënë këtë gjë, unë dua të kaloj në një element tjetër që është shumë i rëndësishëm për këtë tryezë, që është tryeza e parë që ne kemi thirrur, që është tryeza e mirëqeverisjes ose qeverisja e hapur.

Për qeverisjen e hapur ne e dimë që ka disa parime të rëndësishme, siç është parimi i transparencës, ku veprimet e qeverisë janë të hapura dhe veprimet e qeverisë kanë nevojë, doli edhe këtu gjatë diskutimit, që të kenë instrumentet dhe mekanizma më të plotë për të qenë më transparente. Tjetër gjë e rëndësishme është pjesëmarrja e qytetarëve. Nga njëra anë shoqëria civile merr pjesë, por nga ana tjetër mund të ketë grupe të vogla interesi që kanë nevojë të kenë pjesëmarrje më të lartë. Ne kemi përmirësuar disa gjëra në pjesëmarrjen e qytetarëve, por ende kemi detyra për të bërë: progresraporti na ka lënë disa detyra për të shtuar indeksin e realizimit, për shembull, në RIA, për të bërë gjëra të tjera më të mira. Ne kemi nevojë të rrisim llogaridhënien, që është një nga gjërat e rëndësishme, ku vërtetë kërkon llogari qytetari, por a dimë ta japim ne llogarinë në formë të tillë që ta bëjmë mirë e të kuptueshme? Këto dy elemente duhen bashkuar kur flasim për një qeverisje të hapur, duhet të jemi të gatshëm që presioni ndaj qeverisë të jetë një presion që e kupton drejt qytetari atë që po ndodh.

Tjetër gjë, që është shumë e rëndësishme, është se si ne përdorim inovacionin dhe të gjitha teknologjitë e reja që na vihen në dispozicion të këtij procesi dhe qeverisjes së hapur. Kur mendoj inovacion në teknologji, mendoj gjithmonë që shërbimet që kemi krijuar ne në Shqipëri janë shërbime në disa raste edhe model, po e përdor tani, është një element që kemi marrë çmime për disa nga shërbimet që u kemi ofruar qytetarëve, por kemi nevojë shumë për të bërë. Ndërkohë, edhe kur bëhej diskutimi te grupi i ekspertëve për shërbime, mendohej sesi mund ta hapnim shërbimin, sepse ti kur arrin diçka të prekshme, mendon që një vend tjetër paska diçka më shumë, mund ta bëjë edhe unë, por duhet të kuptojmë që këtë ngritje nuk mund ta bëjë vetëm një agjenci, por duhet ta bëjmë të gjithë bashkë për të pasur një rezultat pozitiv, më të qëndrueshëm e më të sigurt në vite. Ky proces, sipas mendimit tim, lidhet me diçka që është shumë e rëndësishme, që doli edhe te tryeza jonë sot: a jemi ne gati që të kemi një sistem monitorimi të mirëkornizuar?

Procesi i monitorimit, e tregoi edhe Irisi, e tregoi edhe Migena, e tregoi edhe Geroni, besoj që do të vijë edhe në tryezat e tjera, ka nevojë për t'u menduar gjatë. Procesi i monitorimit të të gjithë aksioneve *screening* ose edhe i strategjive tona kombëtare ka nevojë për një kornizë të mirë monitorimit. Për këtë në fakt duhet të punojmë ne këtu në Parlament, por duhet të punojnë edhe agjencitë ekzekutive për ta bërë të debatueshme pikërisht në këtë tryezë. Çfarë presim ne në fund të këtij procesi që qenka me 12 tavolina, që qenka për të dalë në vendet ku kemi *critical thinker*, për të thirrur edhe mendimin kritik këtu, që i bëjmë vazhdimisht ftesë opozitës për të qenë pjesë, të vendosim këto gjëra që kanë të bëjnë me monitorime më të mira? Unë besoj se ne në fund do të kemi një dokument analitik, i cili do të jetë më i përditësuar, do të kemi një plan pune dhe në fakt ky është qëllimi ynë, që ne të na gjejë me këto dokumente,

me një adresë *email*-i që funksionon, me një *website* që është gjithmonë e më aktiv, me një dokument i cili është shumë i përditësuar dhe me një plan pune që ka një kornizë monitorimi.

Duke thënë këto, unë mendoj që po i vjen fundi tavolinës, nuk më takon mua, zoti Haçaj, ju takon juve ta thoni, ndërkohë që unë besoj se edhe puna me ekspertët do të vazhdojë, se u bë produkti i parë, do të vazhdojë edhe më tutje dhe ajo që kam vënë re, të më falin ekspertët ta përdor pak këtë, është që më duket se te këto grupet e *whatsapp* që kemi, ku ju punoni vetë e ndonjëherë jemi edhe ne, më duket sikur mesazhet nuk do të mbarojnë kurrë, ka gjithmonë ide të reja aty brenda që vijnë me kërshtërinë që është parë diçka e re dhe munda ta adaptojmë edhe në kushtet e Shqipërisë.

Faleminderit!

Ardian Haçaj - Më mbetet ta mbyll vetëm nga ana formale.

Faleminderit të gjithëve! Ishte nder e kënaqësi dhe shpresoj të ketë nisur mbarë i gjithë ky proces konsultimi.

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit